



FEDERATA
SHQIPTARE E
FUTBOLLIT

Adresa: Rr. "Liman Kaba", Nd 5
Hyrja 1, Njësia Administrative 5
Kodi Postar 1019, Tirana, Albania

Telefon: +35542 346 601
Fax: +35542 346 609
E-mail: info@fshf.al



Nr. 499 Prot

Tiranë më 10.03.2021

Drejtuar: Znj. Ogerta Manastirliu
Ministër
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Për Dijeni: SH.T.Z. Edi Rama
Kryeministër

Komiteti Teknik i Ekspertëve
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Lënda: Mbi mundësimin e pjesëmarrjes së kufizuar të spektatorëve në ndeshjen Shqipëri vs Angli, 28 Mars 2021

E nderuar znj. Ministre,

Siç jeni në dijeni, në kuadër të kompeticionit Kualifikueset Europiane për Kupën e Botës 2022 në Katar, në datën 28 Mars 2021, ekipi kombëtar i Shqipërisë do të zhvillojë ndeshjen e dytë në Shqipëri, Tiranë, kundër kombëtares së Anglisë.

Kjo ndeshje mbart një rëndësi historike si për kompeticionin në kuadër të të cilit zhvillohet, ashtu edhe për vetë ekipin mik që viziton Shqipërinë. Ne si Federatë, jemi të angazhuar për të koordinuar dhe organizuar çdo element të këtij eventit në standardin më të lartë.

Pavarësisht efekteve thellësisht dëmtuese që pandemia COVID-19 shkaktoi në futboll përgjatë vitit 2020, me protokollet strikte dhe rigorozë të hartuara nga FIFA dhe UEFA, futbollit europian ja ka dalë mbanë të ringrihet duke rinisur çdo kompeticion, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Falë këtyre protokolleve që kanë në thelb kujdesin ndaj shëndetit dhe sigurisë së lojës, shumë federata europiane sot po organizojnë ndeshje me pjesëmarrje të spektatorëve. Ky rivitalizim, nisi me organizimin e Super Kupës Europiane nga UEFA në 24 Shtator 2020 në Budapest, me një pjesëmarrje prej 15,180 spektatorësh. Shembuj të rikthimit të spektatorëve në stadione, veçanërisht në kompeticione ndërkombëtare janë Republika Çeke, Danimarka, Norvegjia, Rusia etj. Anglia gjithashtu është një referencë e shkëlqyer sesi paralelisht kujdesit ndaj masave për parandalimin e pandemisë, përmes zbatimit dhe respektimit të protokolleve higjeno-sanitare të FIFA-s dhe UEFA-s, sot zhvillohen ndeshje me prezencën e spektatorëve. Në të gjitha këto shtete, niveli i pjesëmarrjes së spektatorëve shkon deri në 30% të kapacitetit të stadioneve përkatëse. Kjo reflekton mbështetjen ndaj kërkesës në rritje të spektatorëve për t'iu rikthyer emocionit të stadioneve dhe pasionit të tyre për futbollin.

Sponsor Gjeneral



Sponsor Teknik



Premium Sponsor



Sponsor Zyrtarë



UNIONBANK





FEDERATA
SHQIPTARE E
FUTBOLLIT

Adresa: Rr. "Liman Kaba", Nd 5
Hyrja 1, Njësia Administrative 5
Kodi Postar 1019, Tirana, Albania

Telefon: +35542 346 601
Fax: +35542 346 609
E-mail: info@fshf.al



Në këtë kuadër dhe duke synuar që jo vetëm futboli por në përgjithësi jeta sociale të marrë gradualisht kuptimin e harruar, duke shfrytëzuar edhe ndeshjen kundër Anglisë si një premisë historike, kërkojmë shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës sonë për lejimin e kufizuar të spektatorëve në masën 30 % të kapacitetit të stadiumit Air Albania, praktikisht **6500 spektatorë**.

Ne besojmë thellësisht se miratimi i kësaj kërkesë, gjithmonë nën zbatimin rigoroz të protokollit të FIFA-s dhe UEFA-s, Rikthimi në Lojë (Return to Play), do të kontribuojë në normalitetin social të shoqërisë sonë dhe do të shërbejë si një referencë ku kujdesi shëndetësor, disiplina e zbatimit të masave të distancimit social dhe magjia e lojës së futbollit mund të bashkëjetojnë në harmoni.

Në këtë kuadër Federata Shqiptare e Futbollit angazhohet dhe merr përsipër se çdo parashikim i Protokollit të Rikthimit në Lojë, që garanton sigurinë dhe shëndetin e lojtarëve, stafeve dhe spektatorëve do të zbatohet me përpikmëri dhe përgjegjshmërinë më të lartë.

Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin, mbetemi në pritje të një përgjigje pozitive nga ana Juaj.

Me konsideratë,

Ilir SHULKU

Sekretar i Përgjithshëm



Sponsor Gjeneral



Sponsor Teknik



Premium Sponsor



Sponsor Zyrtarë



UNIONBANK

